



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 141

Tiranë – E mërkurë, 5 korrik 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe	
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 480, datë 3.7.2017	Për lirim dhe emërimin në detyrë të drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/ Ndërtimeve Informale.....	6895
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 481, datë 3.7.2017	Për lirim nga detyra.....	6895
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 482, datë 5.7.2017	Për pezullimin e përkohshëm të procedurave të prokurimit, për vitin 2017.....	6895
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 483, datë 5.7.2017	Për blerjen e energjisë elektrike nga shoqëria “KESH”, sh.a., në zbatim të marrëveshjes së huas, të lidhur ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, në përmbushje të detyrimit e shërbimit publik në kushtet e një viti të pafavorshëm hidrik, dhe për një ndryshim në vendimin nr.244, datë 30.3.2016, të Këshillit të Ministrave.....	6896

**VENDIM**

Nr. 480, datë 3.7.2017

**PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN
NË DETYRË TË DREJTORIT
TË PËRGJITHSHËM TË AGJENCISË
SË LEGALIZIMIT, URBANIZIMIT
DHE INTEGRIMIT TË ZONAVE/
NDËRTIMEVE INFORMALE**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 6 të vendimit nr. 289, datë 17.5.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI)”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Ibrahim Morina, drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI), lirohet nga kjo detyrë.

2. Z. Artan Lame emërohet drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

VENDIM

Nr. 481, datë 3.7.2017

PËR LIRIM NGA DETYRA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 6 të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Ildir Peçi, zëvendësministër i Mbrojtjes, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

VENDIM

Nr. 482, datë 5.7.2017

**PËR PEZULLIMIN E PËRKOHSHËM TË
PROCEDURAVE TË PROKURIMIT, PËR
VITIN 2017**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 16 e 40, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 10, të ligjit nr.130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pezullimin e përkohshëm të fillimit dhe të vijimit të procedurave të prokurimit të fondeve në dispozicion të njësive të qeverisjes qendrore dhe të autoriteteve kontraktore në varësi të tyre, për vitin 2017.

Përfshihen nga ky rregull kontratat e nënshkruara para hyrjes në fuqi të këtij vendimi dhe prokurimet për blerjet me vlerë të vogël.

2. Me kërkesë të argumentuar të titullarit të autoritetit kontraktor, për raste të veçanta dhe të nevojave urgjente, me miratimin e Kryeministrit, mund të lejohet vijimi i një procedure prokurimi.

3. Ngarkohen të gjitha institucionet e qeverisjes qendrore, institucionet në varësi të tyre dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

**VENDIM****Nr. 483, datë 5.7.2017****PËR BLERJEN E ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA SHOQËRIA “KESH”,
SH.A., NË ZBATIM TË MARRËVESHJES
SË HUAS, TË LIDHUR NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR
RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, NË
PËRMBUSHJE TË DETYRIMIT E
SHËRBIMIT PUBLIK NË KUSHTET E
NJË VITI TË PAFAVORSHËM HIDRIK,
DHE PËR NJË NDRYSHIM NË
VENDIMIN NR.244, DATË 30.3.2016,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.170/2014, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit për rimëkëmbjen e sektorit të energjisë elektrike”, dhe të nenit 47, të ligjit nr.43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Blerjen e energjisë elektrike nga shoqëria “KESH”, sh.a. për përmbushjen e detyrimit të shërbimit publik ndaj Furnizuesit të Shërbimit Universal në kushtet e një viti të pafavorshëm hidrik. Blerja e energjisë elektrike të bëhet në

zbatim të marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, ratifikuar me ligjin nr.170/2014, në varësi të nevojave dhe për aq sa e lejon vlera e fondit të akorduar nga kjo marrëveshje huaje.

2. Procedura që do ndiqet nga shoqëria “KESH”, sh.a. për blerjen e energjisë elektrike do të jetë në përputhje me parashikimet e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit për rimëkëmbjen e sektorit të energjisë elektrike.

3. Në fund të pikës 3, të nenit 5, në tekstin që i bashkëlidhet vendimit nr.244, datë 30.3.2016, të Këshillit të Ministrave, shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Në raste përjashtimore dhe situata të pafavorshme hidrike, Këshilli i Ministrave mund të vendosë që sasia e nevojshme e energjisë për përmbushjen e kërkesave të klientëve që përfitojnë nga Shërbimi Universal i Furnizimit të sigurohet në tregun e parregulluar nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen pjesërisht apo plotësisht nga shteti.”.

4. Ngarkohen Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe shoqëria “KESH”, sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”

Çmimi 56 lekë